



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Procesverbali për Renovimin dhe punimin e sipërfaqeve rekreative të shtegut në Marash-Kala

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **08.04.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/Njoftim-per-organizimin-e-takimit-publik-per-Renovimin-dhe-punimi-e-siperfaqeve-rekreative-te-shtegut-Marash-Kala.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42797>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-takimit-publik-per-renovimin-dhe-punimi-e-siperfaqeve-rekreative-te-shtegut-marash-kala/>

Me 08.04.2025, njoftimi dhe dokumenti (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtor të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rinore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

Me 15.04.2025, është mbajtur takimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e takimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-takim-publik-per-renovimin-dhe-punimin-e-siperfaqeve-rekreative-te-shtegut-ne-marash-kala/>

Takimi ka filluar në orën 11:10

Hapjen dhe prezantimin e projektit për Renovimin dhe punimin e sipërfaqeve rekreative të shtegut në Marash-Kala në Prizren është bërë nga Alban Krasniqi, Zyrtar i Lartë për Ndërtimtari në DSHP, i cili u ka thënë qytetarëve që ishin në takim se ky është projekt i rëndësishëm dhe se besojmë që ky projekt që ne do të aplikojmë në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Ky projekt do të jetë bashkëfinancim në mes të komunës dhe ministrisë.

Qytetarët që ishin të pranishëm në takim u shprehen se ky është një projekt i shumëpritur dhe presin që të realizohet sa më shpejt që është e mundur në mënyrë që shfrytëzohet nga qytetarët që në vazhdimësi dalin dhe ecin në atë pjesë.

Komentet:

Bashkim Rakaj, kërkoj të informohet se sa është totale e projektit që është planifikuar të investohet në këtë projekt?

Përgjigjja nga zyrtari Alban Krasniqi, ky projekt që financohet nga ministria dhe komuna ka vlerë prej rreth 400 mijë eurove.

Hasan Gashi, kërkoj të informohet se kur pritet të realizohet ky projekt dhe sa është gjatësia e shtegut të planifikuar?

Përgjigjja nga zyrtari Alban Gashi, projekti është planifikuar të realizohet gjatë vitit 2025 dhe gjatësia e shtegut është mbi 1.300.00 metra.

Procesverbali dhe raporti për mbajtjen e takimit publik do të publikohen në këtë vegëz: <https://prizren.rks-gov.net/takimet-publike/>.

Takimi ka përfunduar në orën 11:45

Procesmbajtës:

